

VENDIM QARKULLUES
Nr. 36, datë 30.11.2022

**PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS ALPHA ALBANIA SHA, TË
PËRTHITHUR NGA BANKA OTP ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, pika 1, shkronja “a”, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar; të nenit 8, pika 3 dhe të nenit 9, pika 4, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar; të nenit 18, pika 2, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”; të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 220, pika 3, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 6, të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”; si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 23.11.2022, “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Banka OTP Albania sh.a. me Bankën Alpha Albania sh.a.”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Alpha Albania sh.a. të përthithur nga bashkimi me Bankën OTP Albania sh.a.

2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Alpha Albania sh.a. Ngarkohet Banka OTP Albania sh.a. që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Alpha Albania sh.a. menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Banka OTP Albania sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruara të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Alpha Albania sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Alpha Albania sh.a. si shoqëri e përthithur.

KRYETAR
Donald Duraj